

## KONTRATË PËR SHITJE KUOTASH

Në Tiranë, sot më datë 05.02.2021, lidhet kjo kontratë për shitje kuotash ndërmjet palëve si më poshtë vijon:

- **Z. Agim Zeqo**, shtetas shqiptar, lindur në Korçë, Shqipëri, më 26.08.1968, dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërmjofimit nr. 033727389 dhe me numër personal G80826036H, madhor dhe me zotësi të plotë juridike e për të vepruar (në vijim referuar shkurt si “**Shitësi**”).

dhe

- **Z. Aleksandër Frangaj**, shtetas shqiptar lindur më 04.10.1968, në Zejmen dhe banues në Tiranë, mbajtës i pasaportës Nr. BG6884144 dhe me numër personal G81004099S, madhor e me zotësi të plotë për të vepruar (në vijim referuar shkurt si “**Blerësi**”).

Më poshtë “**Shitësi**” duc “**Blerësi**”, bashkërisht do të referohen dhe si “**Palët**” dhe individualisht dhe si “**Pala**”.

### **MEQENËSE:**

- A. Shitësi zoteron një kuotë të barabartë me 58% (pesëdhjetë e tetë) në kapitalin e shoqërisë **ALIAS DEVELOPMENT SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ushtron aktivitetin në përputhje me ligjet e zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, e regjistruar në Registrin Tregtar të mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me NUIS L61810012B , me seli në adresën: Rr. “Ibrahim Rugova”, Sky Tower, Kati 8/3, Tiranë, Shqipëri dhe me kapital të regjistruar në vlerën 100.00 Lekë (më poshtë referuar si “**Shoqëria**”), kuotë e cila ka vlerë nominale 58 (pesëdhjetë e tetë) Lekë dhe i akordon këtij ortaku të drejta të plota vote sipas legjisacionit shqiptar;
- B. Shitësi ka rënë dakord t'i shesë Blerësit një pjesë të kuotës së zotëruar prej tij në Shoqëri, me vlerë nominale të përgjithshme prej 29 Leke (njëzet e nentë) që i korrespondon 29% (njëzet e nentë për qind) të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë, me të drejtë vote; dhe
- C. Blerësi është dakord të blejë këto kuota nga Shitësi.

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1  
**Objekti i Kontratës**

- 1.1** Shitësi i shet dhe i transferon kuotën Blerësit dhe Blerësi e blen dhe e disponon këtë kuotë nga Shitësi sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.
- 1.2** Kuota do të transferohet menjëherë me nënshkrimin e kësaj Kontrate nga Shitësi tek Blerësi dhe Blerësi do të bëhet pronar me të drejtë të plotë edhe i një kuote në kapitalin e Shoqërisë, të barabartë me 29% (njëzet e nentë për qind) të kapitalit të Shoqërisë, me të drejtë vote sipas ligjit, që i shtohet kuotës që zoteron aktualisht në Shoqëri.

Neni 2  
**Çmimi i Shitjes**

- 2.1** Çmimi i shitjes së Kuotës është i njëjtë me vlerën nominale të saj dhe Palët bien dakord që ky çmim të jetë në shumën totale prej 29 Leke (njëzet e nentë), (më poshtë quajtur “**Çmimi i Shitjes**”).
- 2.2** Palët pranojnë që Çmimi i Shitjes është paguar dhe Shitësi nuk ka asnjë pretendim finansiar kundrejt Blerësit tani dhe/ose në të ardhmen.

Neni 3  
**Deklarime dhe Garanci të Shitësit**

- 3.1** Shitësi nepermjet kësaj Kontrate deklaron dhe garanton Blerësin se:
  - a) Shitësi ka zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar dhe zoteron të gjitha kompetencat në lidhje me nënshkrimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje si dhe lidhur me kryerjen e transaksionit të parashikuar në të; dhe
  - b) Shitësi zoteron kuotën të lirë nga çdo hua, hipotekë, barrë siguruese, peng, marrëveshje kufizuese, kufizim të drejtë transferimi, apo marrëveshje për kufizimin e të drejtës së votës, apo çdo mjet tjetër ligjor që kufizon në ndonjë mënyrë të drejtën e pronësisë mbi kuotat.

Neni 4  
**Përgjegjësia e Shitësit**

- 4.1** Shitësi është përgjegjës për çdo dëm të ndodhur në rast se deklarimet dhe garancitë e parashikuara në Nenin 3 më sipër rezultojnë të pavërteta.


Neni 5  
**Të drejtat dhe detyrimet e Palëve**

- 5.1 Palet gëzojnë të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë Marrëveshje dhe ato që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi si rrjedhojë e lidhjes së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6  
**Të ndryshme**

- 6.1 Kjo Marrëveshje zbatohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë lidhur me këtë Marrëveshje do të zgjidhet nga Palët me mirëkuptim dhe në rast të kundërt, kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- 6.2 Kjo Marrëveshje përbën marrëveshjen e plotë të Palëve si dhe deklarimet e plota dhe ekskluzive të kushteve dhe afateve të parashikuara në këtë Marrëveshje në lidhje me objektin e kësaj Marrëveshje. Kjo Marrëveshje zëvendëson të gjitha marrëveshjet apo mirëkuptimet e mëparshme, me shkrim apo me gojë, që mund të ekzistojnë midis Palëve lidhur me objektin e kësaj Marrëveshje, apo pjese të saj.
- 6.3 Nëse secila prej dispozitave të kësaj Marrëveshje është apo do të bëhet e pavlefshme, pjesërisht apo tërësisht, vlefshmëria dhe legitimiteti i dispozitave të tjera mbetet e pacenuar. Dispozitat e pavlefshme, në masën e lejuar me ligj, do të zëvendësohen me dispozita të tjera të vlefshme dhe të zbatueshme të cilat duhet të janë në përputhje me synimin dhe qëllimin ekonomik të dispozitave që zëvendësojnë, të cilat janë, ose bëhen të pavlefshme e të pazbatueshme.
- 6.4 Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, me vlerë të njëjtë secila. Nga një kopje i jepet secilës Palë, një kopje ruhet pranë arkivit të Shoqërisë dhe një depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**SHITËSI**  
Z. Agim ZEKO



**BLERËSI**  
Z. Aleksandër FRANGAJ

